

**GJYKTA THEMELORE MITROVICE** (ne objektin e deges se kesaj gjykate ne Vushtri), gjyqtari Skender Shala, me qeshtjen juridike kontestimore te paditesit [nga ], kunder te paditures Komuna e [ ] – Drejtoria per Arsim, per pagimin e pagave jubilarë dhe pagave percjellse me rastin e shkuarjes ne pension, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesorë, te mbajtur me dt. 25.04.2016, bie kete:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** kerkesepadia e paditsit [ ] nga [ ] kunder te paditures Komuna e [ ] – Drejtoria per Arsim, per pagimin e pagave jubilarë dhe pagave percjellse me rastin e shkuarjes ne pension e **PA BAZUAR**.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

### **A r s y e t i m**

Paditsi [ ] nga [ ] ka ushtruar padi ne kete gjykate kunder te paditures Komuna e [ ] – Drejtoria per Arsim, per pagimin e te Ardhurave personale, pagave jubilarë dhe pages percjellse me rastin e shkuarjes ne pension.

Ne seancen e shqyrtimit kryesorë theksoi se Mbetem prane padise dhe kerkesepadise se parashtruar, andaj konsideroj se ne baze te nenit 43 dhe 44 te Kontrates kolektive me takojne pagat e cekura si ne kerkespadi. Ne fjalen e tije perfundimtare theksoi se mbetet ne teresi prane kerkespadise, thenjeve te cekura me larte dhe I propozoi gjykates ta aprovoi si te pabazuar.

Shpenzimet e procedures konstestimore i kerkoj

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesorë mbajti ne mungese te Perfaqesuesit te te paditures, conform nenit 423.4 te LPK.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesorë zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-se erdhe ne perfundim se duhet te vendosur si ne dispozitiv te keti Aktgjykimit.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: Vendimin per pushimin e marredhenies te punes per shkak te plotesimit te kushteve per pension te pleqerise nr. te dt. 22.02.2013, leshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit KK , kontraten mbi themelimin e marredhenise se punes te dt. 01.09.2010, vertetimin mbi pervojen e punes nr. te dt. 17.04.2013 leshuar nga Shkolla e meisme e larte teknike “ ” ne kerkesen per kompenzimin e shperblimeve jubirale me rastin e pensionimit te dt.04.04.2013, Lexohet cartifikata e lindjes ne emer te paditesit ted t. 28.03.2013, lista e pagave ku figuron edhe emir I tani paditsit, pergjigja nga e paditura 07-400-9771/13 te dt. 27.04.2013.

Pas analizimit dhe cmuarjes se provave te cekura nje nga nje dhe te gjitha se bashku si dhe rezultateve te tere procedures , gjykata e vleresoi se ne mes te paleve procedurale nuk jane kontestuese keto fakte:

Se paditesi ka qene ne marredhenie pune te e paditura SH.M.L.“ ” ne , dhe ne SH.M. L. “ ” ne vend pune profesor i fizikes

Se paditesit marredhenia e punes I eshte pushuar me arritjen e moshes se pleqerise 65 vjecare, pasi qe nje gje e tille konstatohet nga vendimi mbi pushimin e marredhenes se punes per shkak te plotesimit te kushteve per pension te pleqerise te cekur me larte te dt.22.02.2013 dhe se I njeiti e ka pasur pagen 393.41 €.

Keto jane fakte te provuara me prova e te cilat nuk jane kontestuese per palet ndergjyqese. Kontestuese mbetet ceshtja e pageses se te ardhurave personale si dhe te ardhurave tjera si paga percjellese per shkak te shkuarjes ne pension.

Paditesi kerkesen e vet e mbeshtet ne Kondraten Kolektive konkretisht ne nenet 43 dhe 44.

Gjykata konsideron se ne rastin konkret kerkespadina e paditeses ne lidhje me pagat percjellese per shkak te shkuarjes ne pension eshte e **PA BAZUAR** per keto arsye:

Kontrata Kolektive ne te cilen bazohet kerkesa e paditeses nuk eshte ne fuqi qe nga viti Janari I vitit 2008 , pasi kohezgjatja e kesaj kontrate ka qene per nje periudhe 3 vjecare. Ndersa nga Vendimi per pushimin e marredhenies te punes per shkak te plotesimit te kushteve per pension te pleqerise nr. te dt. 22.02.2013, leshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit KK vertetohet se paditsi eshte pensionuar me dt.23.03.2013.

Kjo specifikohet ne nenin 90.4 te Ligjit te Punes, ku ne menyre decitive thuhet: “Marreshja Kolektive mund te lidhet per nje periudhe te caktuar me kohezgjatje jo me shume se tri (3) vjet”.

Kontrata Kolektive ka hyre ne fuqi ne Janar te vitit 2005, ndersa qe nga Janari i vitit 2008 sipas fuqise ligjore e njejta nuk prodhon kurrfare efektj juridik.

Andaj duke u bazuar ne te larte cekurat bazen ligjore te theksuar me larte dhe interpretimin e saj nga ana e gjykates, arrijme ne perfundim se kerkespadia e paditeses duhet te refuzohet ne teresi si e PA BAZUAR.


Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore, bazohet konform nenit 459.1 te LPK-se.

Nga te cekurat me larte e ne kuptim te nenit 143 te LPK-se u vendos si ne dispozitiv te ketije Aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**

**C.nr.392/13, te dt.25.04.2016.**

**GJYQTARI,**  
Skender Shala



**KESHILLE JURIDIKE** :Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 7 ditesh, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.